RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT "SMART PENSION"

Tetor 2026

Emërtimi i Fondit: Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension ("Fondi")

Shoqëria Administruese: Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.
Monedha Bazë: Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

RREZIK I ULËT — *Përfitime zakonisht të ulëta*

RREZIK I LARTË — *Përfitime zakonisht të larta*

1	2	3	4	5	6	7

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 31.10.2026

Vlera Neto e Aktiveve:	**238.589.683,99 ALL**
Çmimi për kuotë:	**1.205,8719 ALL**
***Kthimi nga Investimit (31 Tetor 2025 - 31 Tetor 2026):**	**4.96%**

**Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*

KOSTOT DHE TARIFAT


- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 1.2% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit;
- Komisioni vjetor i auditimit të Fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese;
- Komisioni i depozitarit të Fondit;
- Tarifa e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare(AMF) do jetë 0.05% në vit e vlerës së aktiveve të Fondit;
- Komisionet e transaksionve me titujt në emër të Fondit.

Kosto totale që do t'i mbahet Fondit nuk mund të kalojë në asnjë rast 1.5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	218,568,243.23	91.47
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	20,375,720.89	8.53

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.



PERIUDHA: 31.10.2025-31.10.2026

Kthimi vjetor neto rezulton 4.96% për periudhën 31 Tetor 2025 - 31 Tetor 2026.
Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 1 vjeçare, 2 vjeçare dhe 3 vjeçare deri më 31 Tetor 2026. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen.
Fondi ka filluar aktivitetin në **12.01.2023.**

Smart Pension	**5Y**	**3Y**	**2Y**	**1Y**
Norma Vjetore e Kthimit	-	5.20	5.03%	4.96%